



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RAPORTI

I MONITORIMIT TË BUXHETIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2024

IIYRJE

Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka realizuar monitorimin e buxhetit të vitit 2024 përmes vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, si dhe krahasimit të nivelit faktik të treguesve të performancës me ato të planifikuar. Ky proces ndiqet në vijimësi nga strukturat përgjegjëse, të cilat kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë në funksion të realizimit të objektivave dhe masave të planit strategjik dhe planit të veprimit të ILD-së për vitet 2023-2025.

Ky raport monitorimi pasqyron realizimin e fondeve buxhetore të ILD-së, të detajuar në nivel kategorie të shpenzimeve buxhetore, kundrejt treguesve të planifikuar, duke mundësuar në këtë mënyrë sigurimin e një informacioni orientues në drejtim të përmirësimit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.

Mbështetur në Ligjin nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, në zbatim të Udhëzimeve të Ministrisë të Financave Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar, dhe Nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për vitin 2024, performanca e realizimit të buxhetit të ILD – së paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI BUXHETOR 03320 “VEPRIMTARIA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË” PËR VITIN 2024

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” është në funksion të përmbushjes me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, të objektivave dhe prioriteteve të institucionit.

Me ligjin nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, për këtë program u miratuan fondet buxhetore në vlerën totale prej **347,300 mijë lekë**, me financim nga buxheti i shtetit, nga të cilat:

1. Për Shpenzime korente 274,300 mijë lekë
2. Për Shpenzime kapitale 73,000 mijë lekë

me një numër të planifikuar prej 101 punonjës, në përputhje me numrin në total të punonjësve sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi me vendimin nr. 28/2020, të ndryshuar. Ky buxhet, në muajin gusht, është shtuar në vlerën 300 mijë lekë me akordimin e fondit të veçantë për vitin 2024.

Me Aktin Normativ nr.3, datë 28.08.2024, buxheti i ILD-së pësoi ndryshime, duke kaluar në vlerën totale **393,300 mijë lekë**.

Nga fondet e lira në grupin e shpenzimeve të personelit, të krijuara si rezultat i vakancave në pozicionet “ Inspektor” u mundësua, nëpërmjet transferimit, shtesë fondi prej 11,600 mijë lekë në total në zërat 602 e 605, për përmbushjen e kufirit të nevojshëm të shpenzimeve buxhetore deri në fund të vitit buxhetor, sipas kërkesave të argumentuara gjatë hartimit të PBA 2024-2026.

Alokimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2024 për veprimtarinë e ILD – së, sipas zërave të shpenzimeve buxhetore është si më poshtë:

Në mijë lekë

Art.	Përshkrimi	Fakti buxheti 2023	Ligji buxheti 2024	Akt Normativ 2024	Fondi i veçan të 2024	Transferime buxheti 2024	Plan buxheti 2024	Fakti buxheti 2024	Realizimi në %
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(5=3+4+5)	(6)	
600	Paga	149,375	218,800	198,800		-11,600	187,200	168,274	89.9
601	Sigurime	20,460	30,000	30,000			30,000	23,878	79.6
602	Mallra shërbime	32,322	23,770	23,770		+11,500	35,270	31,060	88.1

605	Transferta org.ndërk.	-	500	500		+100	600	0	0
606	Transf.për individ.	447	1,230	1,230	300		1,530	443	29
230	Kapitale të patrupëzuara	4,937	-	-			-	-	
231	Kapitale të trupëzuara	954	73,000	139,000			139,000	138,204	99.4
	TOTALI	208,495	347,300	393,300	300	-	393,600	361,859	91.9

PERFORMANCA FINANCIARE DHE JO FINANCIARE E ILD - SË PËR VITIN 2024

Zërat 600-601 "Shpenzime për paga e sigurime",

Buxheti fillestar, i miratuar për këtë grup shpenzimesh me ligjin 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024" është **248,800 mijë lekë**. Gjatë vitit, në vijim të kërkesave të ILD-së, për sigurimin e nevojave të pambuluara për shpenzime në zërat e tjerë të shpenzimeve korrente, ky buxhet është pakësuar nëpërmjet transferimit të fondeve të lira si rezultat i kursimeve të krijuara nga vakancat gjatë vitit, në vlerën 11,600 mijë lekë. Me Aktin Normativ nr.3, datë 28.08.2024, buxheti në zërin 600 u reduktua me 20,000 mijë lekë. Pra, në mbyllje të vitit buxhetor, plani vjetor në zërat 600-601 është **217,200 mijë lekë**.

Për vitin 2024, buxheti i planifikuar është realizuar në vlerën **192,152 mijë lekë, ose në masën 88.4%**, ku përfshihen shpenzimet për paga e sigurime për personelin e organikës dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme.

Numri i punonjësve,

Në buxhetin e vitit 2024, numri i planifikuar është **101 punonjës**, në përputhje me organikën e institucionit, të miratuar me Vendimin nr.28/2020 të Kuventit, të ndryshuar. Kjo organikë është plotësuar me **83 punonjës**, duke rezultuar me 6 vende vakante në pozicionin "Inspektor magjistrat", 5 vende për pozicionin "Inspektor jomagjistrat", 1 vend në pozicionin "Ndihmës inspektor" dhe 6 vende në administratë; kjo situatë ka krijuar mundësinë, që, nga fondet e lira në grupin e shpenzimeve të personelit, të sigurohet shtesa e kërkuar në grupin e shpenzimeve të tjera korrente.

Gjithashtu, në zbatim të VKM nr. 39, datë 24.01.2024, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u miratuan 7 punonjës me kontratë të përkohshme; numri faktik në mbyllje të vitit është 7 punonjës me kontratë të përkohshme.

Zëri 602 "Shpenzime për mallra e shërbime",

Me ligjin 97/2023, u miratua një buxhet prej **23,770 mijë lekë**, nga 35,000 mijë lekë të kërkuara në PBA 2024-2026, duke sjellë vështirësi në planifikimin e shpenzimeve analitike në këtë zë

sipas nevojave buxhetore të përlllogaritura për veprimtarinë e institucionit. Për shkak të planifikimit të pamjaftueshëm, nëpërmjet rialokimit nga fondi i pagave, është siguruar shtesa e fondit prej 11,500 mijë lekë në zërin 602. Në mbyllje të vitit buxhetor, plani vjetor në këtë zë është **35,270 mijë lekë**.

Plani është realizuar në vlerën **31,060 mijë lekë, ose në masën 88.1%**.

Me këtë zë shpenzimesh, është bërë i mundur mbulimi i nevojave administrative, si:

Shpenzime për pagesat e qerasë së ambjenteve, ku stafi i ILD u akomodua gjatë periudhës së rikonstruksionit të godinës, në vlerën 5,057 mijë lekë, shpenzime për shërbimin e sigurisë në vlerën 2,430 mijë lekë, për faturat mujore të energjisë, ujit, shërbimit postar dhe telefonisë në vlerën 1,777 mijë lekë, shpenzime të udhëtimit brenda e jashtë vendit në vlerën 7,020 mijë lekë etj.

Gjithashtu, me zërat e parashikuar në regjistrin e Prokurimeve Publike për vitin 2024, janë realizuar procedurat e prokurimeve, si: blerja e karburantit për automjetet në vlerën 1,153 mijë lekë, sigurimi i ndërtesës, sigurim jete e shëndeti në vlerën 1,082 mijë lekë, rinovimi i afatit të licensave të përdoruesve të Sistemit të menaxhimit të ankesave në ILD në vlerën 4,926 mijë lekë, blerje materiale kancelarie në vlerën 497 mijë lekë, shërbim pastrimi i zyrave dhe ambjenteve në vlerën 827 mijë lekë, shërbim interneti në vlerën 120 mijë lekë, shërbim programi financiar në cloud në vlerën 340 mijë lekë, për mirëmbajtjen, larjen, siguracionet dhe taksat vjetore të automjeteve në vlerën 891 mijë lekë, etj.

Zëri 605 " Transferta për org. Ndërkombëtare "

Fondi i kërkuar për pagesën për RESIJ (Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit), ku ILD është anëtar që prej qershorit të vitit 2023, të kuotës vjetore prej 5000 Euro. Fondi nuk është realizuar, pasi, gjatë vitit 2024, nuk është përcjellë njoftim zyrtar/ dokument financiar lidhur me pagesën e detyrimit.

Zëri 606 " Transferta për buxhetet familjare dhe individët "

Me ligjin 97/2023, u miratua një buxhet prej **1,230 mijë lekë** për mbulimin e kufirit të shpenzimeve të telefonisë celulare për kategoritë e funksionarëve të parashikuar në VKM nr.673, datë 02.09.2020, të ndryshuar. Fondi është realizuar në vlerën **215 mijë lekë**, ose në masën 17.4% të planit vjetor.

Gjithashtu, për vitin 2024, nga Ministria e Financave është alokuar fondi i veçantë prej **300 mijë lekë**. Ky fond është përdorur për ndihmë të menjëhershme për rast fatkeqësie në vlerën 30 mijë lekë, për dalje në pension pleqërie në vlerën 63 mijë lekë, si dhe për ndihmë financiare për punonjësit mbështetës në zbatim të VKM nr.846 dt.26.12.2024 në vlerën 135 mijë lekë. Në total, ky fond është realizuar në vlerën **228 mijë lekë**, ose në masën 75.9%.

Zëri 231 " Shpenzime kapitale "

Buxheti në dispozicion të ILD për vitin 2024, miratuar me ligjin 97/2023, ishte në total **73,000 mijë lekë**. Në vijim të kërkesave të ILD për sigurimin e financimit të plotë nga buxheti i shtetit të punimeve të rikonstruksionit të godinës, me Aktin Normativ nr.3, datë 28.08.2024, ky buxhet u rrit me 66, 000 mijë lekë, duke e çuar në **139,000 mijë lekë**.

Në total, ky fond është realizuar në vlerën **138,204 mijë lekë**, ose në masën 99.4% të planit vjetor, sipas projekteve të investimeve, si më poshtë:

- 1) Projekti “Rikonstruksion i zyrave dhe ambjenteve të ILD”, kodi M630008 - në ligjin vjetor të buxhetit 2024, u planifikua fondi në vlerën 63,000 mijë lekë. Shtesa e miratuar prej 66,000 mijë lekë me Aktin Normativ nr.3, datë 28.08.2024, duke e çuar në vlerën 129,000 mijë lekë buxhetin në këtë projekt, bëri të mundur mbylljen e punimeve të rikonstruksionit, brenda afatit të parashikuar në modifikimin nr. 1, datë 28.12.2023 të kontratës së zbatimit. Gjithashtu, nëpërmjet transferimit brenda zërave të shpenzimeve kapitale për vitin 2024, u sigurua shtesë fondi prej 800 mijë lekë për të mbuluar vlerën e plotë të detyrimit për mbikqyrësin dhe kolaudatorin.

Kosto e plotë e projektit të rikonstruksionit të godinës, të financuar nga Buxheti i shtetit **në harkun e viteve buxhetorë 2021-2024**, është si më poshtë:

- Realizimi i detyrës së projektimit dhe hartimi i projekt - preventivit, vlera 4,070 mijë lekë.
- Punimet e zbatimit të projektit të godinës, të rishikuar, vlera totale 139, 881 mijë lekë .
- Mbikqyrja dhe kolaudimi i punimeve të rikonstruksionit, në vlerën 1,489 mijë lekë.

TOTALI I PROJEKTIT: 145,440 mijë lekë.

- 2) Projekti “Blerje automjetesh”, kodi M630020 - në ligjin vjetor të buxhetit 2024, u miratua fondi prej 10,000 mijë lekë. Ky fond u realizua në vlerën 6,492 mijë lekë. Fondi i kursyer nga procedura e prokurimit në këtë projekt, u pakësua me transferim brenda grupit të shpenzimeve kapitale në vlerën 3,500 mijë lekë , me qëllim mbulimin e nevojave për pagesën e mbikqyrësit dhe kolaudimit të punimeve të rikonstruksionit, si dhe për pajisjen e zyrës së protokollit pas përfundimit të rikonstruksionit me rafte arkive dhe për blerje pajisje të tjera zyre.
- 3) Projekti “ Pajisje zyre”, kodi M630001. Mbështetur në udhëzimin standard të buxhetit, Ministria e Financave miratoi transferimin nga projekti “ Blerje automjetesh” të fondit prej 2,700 mijë lekë për blerjen e rafteve të arkivës dhe orendi zyre, të nevojshëm pas hyrjes në ambjentet e rikonstruktuar. Fondi u realizua në vlerën 1,999 mijë lekë.

Për vitin 2024, buxheti i planifikuar për shpenzime kapitale, është realizuar sipas projekteve, si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Art.	Kodi	Emërtimi	Plan buxheti 2024	Fakti 2024	Diferenca 2024	Realizimi në %
231	M630001	Blerje pajisje zyre	2,700	1,999	701	74
231	M630008	Rikonstruksione	129,800	129,713	87	99.9
231	M630020	Blerje automjete	6,500	6,492	8	99.9
		TOTALI	139,000	138,204	796	99.4

❖ Treguesit kyç të performancës

Për vitin 2024, në nivel qëllimi të politikës së programit janë parashikuar 2 tregues performance, e konkretisht:

- ✓ Përgatitja e kuadrit rregullator për vlerësim dhe monitorim në funksion të krijimit të një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë.
- ✓ Rritja e transparencës nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit me publikun.

Në nivel objektiv, për vitin 2024 kemi këta tregues kyç të performancës:

- ✓ Rritja e standardeve me qëllim zhvillimin e procesit të hetimor disiplinor në përputhje me parimet e ligjshmërisë e të procesit të rregullt ligjor sipas standardeve ndërkombëtare, përmes ndjekjes së aktiviteteve trajnuese, pjesëmarrjes aktive në forume profesionale dhe zhvillimin e vizitave studimore në inspektoratet homologe evropiane.
- ✓ Shqyrtimi me profesionalizëm dhe efektivitet i ankesave të paraqitura.
- ✓ Realizimi i planit vjetor të inspektimeve ligjore dhe tematike.

❖ Produket: Për programin buxhetor “ Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, realizimi i Produkteve ka qenë si më poshtë:

Produkti “Inspektime të kryera/ankesa të trajtuara” -

- I. Gjatë vitit 2024 është miratuar plani i inspektimeve ku janë përcaktuar tematikat e mëposhtme:
 1. "Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023";
 2. "Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023";

3. "Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023– 31.12.2023";
4. "Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore për periudhën 01.03.2023 – 31.05.2023";
5. "Mbi procedurën e shpalljes dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore për periudhën 01.01.2023 – 01.06.2023";
6. "Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023".

Në lidhje me vijueshmërinë e këtyre inspektimeve sqarojmë se është përfunduar inspektimi tematik:

- "Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023".

Inspektimet e tjera pjesë e këtij plani janë në proces dhe në faza të ndryshme procedurale.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 kanë përfunduar edhe 3 inspektime tematike të cilat kanë qënë pjesë e planit të inspektimeve për vitin 2023, konkretisht:

- "Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022";
- "Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022";
- "Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2022– 31.12.2022".

II. Gjatë vitit 2024, numri i ankesave të shqyrtuara është 1320, të ndara në vendimet e arkivimit si më poshtë:

993 ankesa të arkivuara pas shqyrtimit fillestar;

327 ankesa të arkivuara pas verifikimit.

Në lidhje me kërkesa për procedim, nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë dërguar në këshilla gjithsej 11 kërkesa për procedim disiplinor.

Sa i përket hetimeve, nga ana e kësaj zyre janë marrë 23 vendime hetimi disiplinor për 25 subjekte të hetimit.

Produkti "**Godinë e rikonstruktuar**" - në buxhetin e vitit 2024 janë planifikuar 63,000 mijë lekë për rikonstruksionin e zyrave dhe ambjenteve të godinës së ILD. Siç raportuam më lart, me shtesën e miratuar në AN nr.3 dt.28.08.2024, u arrit përfundimi në kohë dhe dorëzimi i këtij objekti.

Produkti "**Automjete të blera**" - në buxhetin e vitit 2024 u planifikuan 10,000 mijë lekë për sigurimin e 2 automjeteve në dispozicion të njësisë së inspektorëve. Ky fond është realizuar, duke siguruar blerjen e 2 automjeteve, në zbatim të kontratës nr.439/9 prot., datë 12.04.2024 në vlerën 6,492 mijë lekë.

Produkti "**Pajisje zyre të blera**", me fondin e siguruar nga transferimi brenda grupit të shpenzimeve kapitale, u bë e mundur furnizimi dhe vendosja e rafteve për arkivimin e dokumenteve, dhe pajisje e orendi të tjera.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Emri i Grupit Vepërimitarja e Mblikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë	Kodi i grupit Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										63	
	Viti paraardhës 2023		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese			
	Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillostar Vjetor Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/progressive	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)		% e realizimit
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (5-3))	(8)	(9)	10 (5-8)	11 (8/5)		
Shpenzimet sipas programeve buxhetore												
Kodi i Programit	Emërtimi											
03320	Vepërimitaria e Zyres së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	208 495,185.50	100%	347,300,000.00	100%	393,600,000.00	100%	46,300,000.00	361,859,391.50	100%	31,740,608.50	91.94%
	Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01,02,03,04,05,06,22)	208 495,185.50	100%	347,300,000.00	100%	393,600,000.00	100%	46,300,000.00	361,859,391.50	100%	31,740,608.50	91.94%
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0.00	0%	0.00	0%
	Totali Shpenzimeve të Ministrisë	208 495,185.50	100%	347,300,000.00	100%	393,600,000.00	100%	46,300,000.00	361,859,391.50	100%	31,740,608.50	91.94%
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Artikulli	Emërtimi											
600	Paga	149 375,394.00	74%	218 800,000.00	80%	187,200,000.00	74%	-31,600,000.00	168,274,989.00	75%	18 925,071.00	89.89%
601	Sigurime Shqetore	20 459 837.00	10%	30 000,000.00	11%	30 000,000.00	12%	0.00	23,877,535.00	11%	6 122,465.00	79.59%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	32 322 346.50	16%	23 770,000.00	9%	35 270,000.00	14%	11,500,000.00	31,059,653.51	14%	4 210,346.49	86.06%
603	Subvencione		0%	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0.00	0%	0.00	0%
604	Transferita Korente të Brendshme		0%	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0.00	0%	0.00	0%
605	Transferita Korente të Huaja		0%	500,000.00	0%	600,000.00	0%	100,000.00	0.00	0%	600,000.00	0%
606	Trans per Buxh Fam. & Individ	446 808.00	0%	1 230,000.00	0%	1 530,000.00	1%	300,000.00	443,175.00	0%	1 086,825.00	28.97%
	Nen-Totali Shpenzime Korente	202 604,385.50	100%	274,300,000.00	100%	254,600,000.00	100%	-19,700,000.00	223,655,352.51	100%	30,944,647.49	87.85%
230	Kapitale të Patruëzuara	4 936 800.00	84%	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0.00	0%	0.00	#DIV/0!
231	Kapitale të Trupëzuara	954,000.00	16%	73,000,000.00	100%	139,000,000.00	100%	66,000,000.00	138,204,038.99	100%	795,961.01	99.43%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	5,890,800.00	100%	73,000,000.00	100%	139,000,000.00	100%	66,000,000.00	138,204,038.99	100%	795,961.01	99.43%
230	Kapitale të Patruëzuara	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0.00	0%	0.00	0%
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0.00	0%	0.00	0%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0.00	0%	0.00	0%
	Totali Shpenzime Kapitale	5,890,800.00	100%	73,000,000.00	100%	139,000,000.00	100%	66,000,000.00	138,204,038.99	100%	795,961.01	99.43%
	Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor	208 495,185.50	100%	347,300,000.00	100%	393,600,000.00	100%	46,300,000.00	361,859,391.50	100%	31,740,608.50	91.94%
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0%	0.00	0.00	0%	0.00	0%
	Totali (Korente + Kapitale + Shpenz. nga te ardh. jashte limiti)	208 495,185.50	100%	347,300,000.00	100%	393,600,000.00	100%	46,300,000.00	361,859,391.50	100%	31,740,608.50	91.94%
	Numri i punonjësve	79		101		101			83			

Sekretari i Përgjithshëm

Emri
Firma
Data

